







Analizë:

# SFIDAT E PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT HAPËSINOR NË KOMUNA

## ROLI I SHOQËRISË CIVILE NË ADRESIMIN E TYRE





Analizë:

**SFIDAT E PLANIFIKIMIT DHE  
MENAXHIMIT HAPËSINOR NË KOMUNA**  
ROLI I SHOQËRISË CIVILE NË ADRESIMIN E TYRE



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e EC Ma Ndryshe dhe PRO-Planning dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së dhe KCSF-së.

Kjo analizë është përgatitur nga Qendra Kosovare për hulumtime urbane-PRO-Planning, Prishtinë për organizatën EC Ma Ndryshe.

Botues: EC Ma Ndryshe  
Autor: Qendra Kosovare për hulumtime urbane  
PRO-Planning  
Përkthimi në serbisht: Mohamed Sagdati  
Dizajn dhe faqosje: Bubrecat

Rr. Saraçët 5, 20000/Prizren  
Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, 10000/Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org)  
[info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
038-224-967  
029-222-771

# PËRMBAJTJA

Shkurtesat	4
Hyrja	5
Metodologjia	6
I. PREMISAT PËR ANALIZË	7
1.1. Statusi aktual i akteve nënligjore	8
II. SFIDAT E PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT HAPËSINOR NË KOMUNA	10
2.1. Korniza ligjore dhe dokumentet e planifikimit hapësinor	10
2.2. Kapacitetet njerëzore, organizative dhe financiare	14
2.3. Mbështetja politike dhe bashkëpunimi ndër-institucional dhe më gjerë	17
2.4. Pjesëmarrja publike në proceset e planifikimit dhe menaxhimit hapësinor	18
III. ROLI I SHOQËRISË CIVILE NË TRAJTIMIN E SFIDAVE	21
Referencat	22

## SHKURTESAT

MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
HZKos	Harta Zonale e Kosovës
PHK	Plani Hapësinor i Kosovës
HZK	Harta Zonale e Komunës
UA	Udhëzim Administrativ
DU	Drejtoria e Urbanizmit
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
KPH	Kolegjiumi për planifikim hapësinor
PRrU	Plan Rregullues Urban
PRrH	Plan Rregullues i Hollësishëm
USAID	United States Agency for International Development
UN-Habitat	United Nations Human Settlement Programme
IRUSP	Implementation and Enforcement of Rural Spatial Planning
GIS	Geographic Information Systems
MAPL	Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal
AKS	Agjencioni i Statistikave të Kosovës
OShC	Organizatat e Shoqërisë Civile

## HYRJE

Kosova pas lufte u ballafaqua me një kaos të vërtetë në aspektin e planifikimit hapësinor dhe urbanistik. Urbanizimi i shpejtë si rezultat i migrimit të popullatës nga viset rurale në ato urbane si dhe nga qytetet e vogla kah qendrat më të mëdha, në kërkim të kushteve më të mira për jetë, punë, shkollim rezultoi me zgjerimin e pakontrolluar të qyteteve. Autoritetet lokale u gjendën të papërgatitura të përballojnë këtë trend të urbanizimit. Migrimi u manifestua me rritjen e popullatës urbane, zgjerim të qyteteve që u përcjell më tutje me zvogëlimin e fondit tokësor, mungesë të infrastrukturës, shërbimeve sociale dhe probleme mjedisore.

Planifikimi hapësinor (PH) ka funksion zhvillimor dhe rregullues. Si mekanizëm për zhvillim, me PH qeveria përcakton një vizion afatgjatë të zhvillimit të qëndrueshëm social, ekonomik dhe hapësinor të një territori, mbi të cilin ndërtohen strategjitë /programet prioritare për zbatim për të mundësuar ofrimin e shërbimeve dhe infrastrukturës, përcaktimin e kahjeve të zhvillimit urban dhe rural, ruajtjen e burimeve kombëtare, krijimin e një klime të favorshme për investime, etj. Ndërsa si mekanizëm rregullues, qeveria (si në nivel lokal, dhe atë qendror) duhet të jep miratimin për zhvillim të aktiviteteve të caktuara në këto fusha përmes dispozitave për zbatim të tyre në pajtim me planet strategjike.

Me themelimin e institucioneve qendrore përkatësisht MMPH, me synim të rregullimit të planifikimit hapësinor në territorin e Kosovës është iniciuar reforma e legjislacionit në këtë fushë me hartimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor LPH-2003/14. Ky ligj sjell një metodologji të re në planifikim hapësinor, të drejtuar nga qasja strategjike në planifikim dhe qasja interdisiplinare në zbatim.

Si rezultat i zbatimit të këtij ligji është hartuar PHK (Plani Hapësinor i Kosovës) nga MMPH si dhe PZHK, PZHU dhe PRrU nga shumë komuna të Kosovës. Për fat të keq, për shkak të një sërë arsyesh socio-politike, ekonomike dhe të tjera,

planifikimi dhe zhvillimi ndodhi më ngadalë se sa ishte parashikuar dhe sistemi i planifikimit nuk është zhvilluar në drejtimin e pritur, duke çuar në rritjen e shpejtë të ndërtimeve të paligjshme - afro 350.000 sosh, në gjithë territorin e Kosovës. Gjendja në hapësirë është degraduar, duke prodhuar efekte afatgjata të padëshirueshme në organizimin hapësinor dhe formësimin e zonave urbane dhe rurale.

Në përpjekje për të adresuar situatën e krijuar dhe si përgjigje ndaj kërkesave për lehtësim të procedurave në dhënien e lejeve të ndërtimit në funksion të nxitjes së zhvillimit përmes investimeve vendore dhe atyre të huaja, është iniciuar ndryshimi legjislacionit të kësaj fushe. Në tri vitet e fundit është hartuar pako e re e ligjeve: Ligji për ndërtim 04/L - 110, Ligji për Planifikim Hapësinor 04/L-174, Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje 04/L-18 si dhe disa Udhëzime administrative për lehtësimin e zbatimit të tyre.

Me LPH 04/L-174 është bërë ridefinimi i sistemit të planifikimit hapësinor në Kosovë. Është vënë në pah më shumë monitorimi i zbatimit të planeve si dhe janë qartësuar rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve përgjegjëse për planifikim dhe menaxhim hapësinor në nivel qendror dhe lokal. Një lloj i ri i dokumentit të planifikimit - Harta Zonale, është futur në të dy nivelet e planifikimit, ndërsa komunat jo detyrimisht por sipas vlerësimit të tyre, mund të hartojnë Plane Rregulluese të Hollësishme për zona të përcaktuara nga PZHK dhe HZK. Është inkurajuar pjesëmarrja e publikut gjatë procesit të planifikimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor në të dy nivelet. Një numër i akteve nënligjore janë parashikuar të hartohen brenda një viti, ndërkohë që deri në hartimin e UA të reja, aktet ekzistuese nënligjore do të mbeten në fuqi nëse zbatueshmëria e tyre nuk bie ndesh me kornizën aktuale ligjore.

Reforma e ndërmarrë në legjislacionin e planifikimit hapësinor dhe ndërtimit ka pasë për qëllim arritjen e një efikasiteti më të lartë në fushën e rregullimit dhe menaxhimit hapësinor. Përderisa ekziston përshtypja se ato nuk kanë mundësuar

progres të dukshëm në këtë fushë, është e nevojshme të krijohet një pasqyrë më e qartë lidhur me situatën aktuale në komunat e Kosovës. Si detyrë primare e Qeverive lokale është sigurimi i mirëqenies për qytetarët e tyre përmes krijimit të një mjedisi të qëndrueshëm për investime publike dhe private dhe një mjedisi të shëndoshë dhe atraktiv për jetë. Planifikimi hapësinor është instrumenti kyç që qeveritë lokale kanë në dispozicion për të arritur këtë qëllim.

Prandaj, në kontekstin e krijuar, është parë e arsyeshme që të zhvillohet një analizë e cila do të vë në pah sfidat kryesore të planifikimit dhe menaxhimit hapësinor në komunat e Kosovës si dhe rolin e shoqërisë civile në trajtimin e tyre.

## METODOLOGJIA

Hulumtimi është zhvilluar gjatë muajit Mars 2016 përmes pyetësorëve dhe bisedës interaktive me drejtorë dhe zyrtarë të autoriteteve komunale për planifikim dhe menaxhim hapësinor në 14 komuna (rreth 30% ) të Kosovës. Mostra e analizuar përfshin komuna nga ato të mëdha, të mesme dhe të vogla të paraqitura në vijim: Prishtina, Peja, Prizreni, Gjilani, Ferizaj, Mitrovica, Fushë Kosova, Klina, Podujeva, Kamenica, Malisheva, Graçanica, Juniku dhe Mamusha.

Analiza e situatës ekzistuese në fushën e planifikimit dhe menaxhimit hapësinor është strukturuar sipas aspekteve vijuese: Korniza Ligjore dhe Dokumentet e planifikimit; Kapacitetet njerëzore, organizative dhe financiare; Mbështetja politike bashkëpunimi ndërinstytucional; Pjesëmarrja publike dhe më gjerë.

Duke u bazuar në të gjeturat nga intervistat e zhvilluara në komunat e lartpërmendura, analiza do të ofrojë konkluzione mbi sfidat kryesore të planifikimit dhe menaxhimit hapësinor dhe rekomandime për pwr autoritetet pwrgegjwse pwr planifikimin dhe menaxhimin hapësinor nw tejkalimin e tyre. Në veçanti është analizuar edhe roli i Organizatave të shoqërisë civile në adresimin e ketyre sfidave



## I. PREMISAT PËR ANALIZË

Ligji për planifikim hapësinor Nr.04/L-174 është aprovuar më 31 korrik 2013 duke shfuqizuar kështu Ligjin 2003/14. Sipas këtij ligji (LPH), Qeveria dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) brenda një viti nga dita e hyrjes së tij në fuqi, harmonizon dhe nxjerr aktet nënligjore përmes të cilave kompletohet korniza ligjore. Bazuar në këtë, qeveritë lokale në pajtim me afatet e përcaktuara, obligohen të përbushin një sërë kërkesash, të prezantuara në tabelën 1.

**Tabela 1: Kërkesat ligjore për institucionet e qeverisë lokale dhe qendrore në hartimin dhe aprovimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor**

Intitucioni	Përgjegjësia	Afati kohor
Qeveria dhe MMPH	Harmonizon aktet nënligjore ekzistuese dhe nxjerr aktet e reja nënligjore që të ligjit të ri (neni 27).  Shënim: Deri në sjelljen e akteve të reja nënligjore, ato ekzistuese mbesin në fuqi përderisa nuk bijnë ndesh me dispozitat e ligjit	Gusht 2014
MMPH	Themelon dhe mirëmban Bazën e konsoliduar të dhënave të Planifikimit hapësinor (neni 19, paragrafi 1 dhe 7)	Gusht 2014
	Trajnimi i zyrtarëve komunalë në shfrytëzimin e të dhënave digjitale bazë dhe normat e planifikimit hapësinor	Maj 2014
	Hartimi i Hartës Zonale të Kosovës në përputhje me Planet zhvillimore komunale, Planet Zhvillimore Urbane dhe Planet Rregulluese Urbane të miratuara nga Kuvendet komunale dhe në pajtim me dispozitat e këtij ligji (neni 26, paragrafi 1)	Maj 2014
Komunat	Dorëzimin në MMPH të dokumenteve të miratuara (PZHK, PZHU, PRRU-të) në formë digjitale (neni 26, paragrafi 2)	Gusht 2014
	Komunat që kanë Planin Zhvillimor Komunal, Planin Zhvillimor Urban dhe Planet Rregulluese Urbane, brenda 15 muajve të hyrjes në fuqi të këtij ligji duhet të hartojnë dhe aprovojnë Hartën Zonale të Komunës (neni 26, paragrafi 3)	Nëntor 2014
	Komunat që nuk kanë Planin Zhvillimor Komunal dhe Planin Zhvillimor Urban të aprovuar, brenda 15 muajve të hyrjes në fuqi të këtij ligji hartojnë dhe aprovojnë dokumentet e planifikimit hapësinor (neni 26, paragrafi 4)	Nëntor 2014

Komunat	Përgadisin bazën e të dhënave komunale dhe dorëzojnë atë në Ministri	Nuk ka përcaktim kohor
	Vijojnë trajnimin e ofruar nga Ministria lidhur me përdorimin e të dhënave digjitale bazë dhe Normave teknike të planifikimit hapësinor.	Maj 2014
	Informojnë në baza vjetore MMPH-në për gjendjen e Planit zhvillimor komunal, Hartës zonale komunale dhe Planeve rregulluese të hollësishme dhe nivelin e zbatimit të tyre.	Në vazhdimësi

Nëse komunat dështojnë në përmbushjen e përgjegjësisë të tyre të parapara me dispozitat e këtij ligji, Ministria është përgjegjëse për hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor në nivel lokal, në bashkëpunim me komunat (neni 26, paragrafi 4).

Ministria për hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor mund të sigurojë edhe donacione nga institucionet vendore e ndërkombëtare përpos burimeve financiare të alokuara nga Qeveria (neni 9, paragrafi 4).

## 1.1. Statusi aktual i akteve nënligjore

Nga gjithsej 11 sosh, aktualisht janë katër akte nënligjore në proces të hartimit dhe tri akte nënligjore të aprovuara të cilat përfshijnë:

- Udhëzimin Administrativ (UA) për Elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal;
- UA për Elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës dhe
- UA për Përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor, parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor).

**Tabela 2: Statusi i akteve nënligjore**


Nr	Neni referues	Akti nënligjor	Statusi
1	9.5.	Normat teknike të Planifikimit hapësinor	Në proces
2	9.6.	Fushëveprimi dhe përgjegjësitë e Institutit për Planifikim Hapësinor.	Në proces

3	12.5.	Elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Hapësinor të Kosovës.	Në proces
4	13.4.	Elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Kosovës.	Në proces
5	14.7.	Klasifikimin, detyrat, përgjegjësitë dhe përmbajtjen e elementeve dhe kërkesave themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Hapësinore për zona të veçanta.	Jo
6	15.5	Elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal.	Aprovuar
7	16.4.	Elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës.	Aprovuar
8	17.10	Elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme.	Jo
9	19.4.	Metodën e mirëmbajtjes së bazës së të dhënave dhe obligimet e autoriteteve publike dhe personave tjerë fizik dhe juridik sa i përket mirëmbajtjes dhe dorëzimit të dokumenteve dhe të dhënave në bazën e të dhënave.	Në proces
10	20.3.	Përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor, parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor	Aprovuar
11	25	Rregullimin e mbikëqyrjes, ndëshkimeve dhe marrjen e masave ndaj çdo forme të shkeljes së këtij ligji.	Jo

## II. SFIDAT E PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT HAPËSINOR NË KOMUNA

### 2.1. Korniza ligjore dhe dokumentet e planifikimit hapësinor

Në përpjekjet për të arritur planifikim efektiv ligji 04/L-174 ka prezantuar strukturën e re të dokumenteve të planifikimit hapësinor si në nivelin



Sa jeni të njohtuar me zhvillimet lidhur me reformën e kornizës ligjore në planifikim hapësinor?

qendror ashtu edhe në atë lokal, të vendosura në një sistem hierarkik dhe interaktiv. Të dy nivelet kanë plane multi-sektorale të karakterit strategjik si Plani Hapësinor i Kosovës (PHK) dhe Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) si dhe një lloj të ri të planeve që kanë më tepër karakter rregullues/zbatues si Harta Zonale e Kosovës dhe Harta Zonale e Komunës. Këto plane, edhe pse të ndërlidhura, janë dokumente të veçanta që zhvillohen dhe miratohen nëpërmjet procedurave të veçanta dhe në mënyrë të njëpasnjëshme.

Sa janë të informuara komunat mbi reformën e kornizës ligjore, sa kanë arritur ato t'i përmbushin kërkesat e ligjit të ri, cilat janë sfidat me të cilat ato ballafaqohen gjatë hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor janë tema të trajtuara gjatë analizës.

Shumica e komunave të anketuara (71%),

deklarojnë se janë mirë të informuara me reformën e kornizës ligjore në planifikim hapësinor. Informacioni në të shumtën e rasteve është marrë përmes shkresave nga MMPH/ Departamenti i Planifikimit Hapësinor, apo dhe web-faqja e MMPH dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës. Ka dhe të tilla raste kur komuna është informuar rastësisht përmes kolegëve nga komunat tjera nga takimet e përbashkëta apo dhe organizatave të huaja të cilat i mbështesin komunat në punën e tyre. Duke kritikuar mënyrën e njoftimit përmes shkresave zyrtare, sugjerimet janë që në të ardhmen të përdoren takime punuese të fokusuar në shtjellimin e përmbajtjes së ligjit.

#### Prej kujt jeni të informuar për reformën e kornizës ligjore në planifikim hapësinor?

MMPH	53%
AKK/KPH	18%
Vet përmes faqes së internetit	24%
Mënyra tjera	5%

Në raport me përmbushjen e kërkesave ligjore të LPH, të gjeturat nga intervistat rezultojnë:

- 78 % e komunave të intervistuar deklarojnë se kanë dorëzuar në MMPH dokumentet e miratuara (PZHK, PZHU, PRRU-të) në formë digjitale. Është komentuar për mungesën e specifikimit të qartë në ligj lidhur me atë se çfarë saktësisht nënkupton forma “digjitale” e dokumenteve PDF, GIS apo tjetër.
- 50 % e komunave të intervistuar kanë ndjekur trajnimet e organizuara nga MMPH përmes donatorëve mbështetës të saj (programit të USAID, UN-Habitat dhe IRUSP). Mos-ndjekja e trajnimeve në disa raste ndërlidhet me adresimin e ftesave për trajnime tek drejtorët të cilët më pas nuk procedojnë ftesat tek zyrtarët përgjegjës apo meqenëse ka ndërrime të drejtorëve dhe ftesat mbesin të pa-adresuara tek staf kom-

petent. Pavarësisht kësaj, zyrtarët komunal kanë dyshime se a janë aftësuar mjaftueshëm në shfrytëzimin e të dhënave digjitale, gjë që do të detyronte komunat të kontraktojnë këto shërbime gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor.

- Me përjashtim të komunës së Malishevës e cila është në proces të finalizimit të PZHK-së sipas ligjit të ri, të gjitha komunat tjera të intervistuar i kanë PZHK të aprovuara sipas legjislacionit paraprak. Në mesin e tyre, ato të cilat planifikojnë revidimin e PZHK me qëllim të adaptimit apo harmonizimit me legjislacionin e ri janë:
  - Fushë Kosova e cila planifikon të zhvillojë PZHK me forca vetanake;
  - Ferizaj ka marrë vendim për iniciimin e procedurave për hartimin e PZHK dhe ka tenderuar për shërbime konsultente, asistencë teknike;
  - Gjilani në planifikimin e buxhetit për vitin 2016 ka paraparë revidimin e PZHK-së.
- Për komunën e Mitrovicës, mosdefinimi i kufijve me komunën e Mitrovicës Veriore ka bërë që hartimi i PZHK-se të mos mund të fillojë, duke mbetur peng i ndarjes administrative.
- Komunat nuk kanë arritur të plotësojnë kërkesën ligjore sa i përket hartimit të Raportit monitorues të zbatimit të dokumenteve të planifikimit. Ka pak progres në lidhje me informimin vjetor në MMPH lidhur me gjendjen e dokumenteve të planifikimit. Krijimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të qëllimeve dhe të objektivave të deklaruara në PZHK dhe HZK konsiderohet një sfidë e vërtetë. Aktualisht i vetmi monitorim është në bazë të lejeve të dhëna.
- Gjatë intervistave është ngritur shqetësimi rreth paqartësive në interpretimi ligjor në lidhje me revidimin e PZHK.

- Komunat: Pejë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë, Kamenicë dhe Podujevë kanë bërë planifikimin e buxhetit për hartim të HZK, kurse komuna e Prishtinës ka filluar punët përgatitore për hartim të saj.

Zyrtarët e komunave e shohin si mjaft sfidues hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor, PZHK dhe në veçanti HZK. Ligji e obligon Autoritetin Përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor që të harton PZHK përmes koordinimit të drejtorive sektoriale dhe burimeve njerëzore brenda komunës, përdërisa jo të gjithë zyrtarët janë të përgatitur t'i përgjigjen kësaj në mënyrë të kënaqshme.

Në lidhje me këtë përgjigjet gjatë intervistave kanë treguar se:


- Ka nevojë për një interpretim më të qartë të LPH në mënyrë që të evitohen problemet gjatë zbatimit të tij. Në pyetjet e tyre lidhur me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit, komunat kanë marrë interpretime jokonsistente dhe të pakoordinuara nga ana e zyrtarëve të MMPH.
- Mungesa e stafit e në veçanti përvojës në hartim të këtyre dokumenteve, është paraqitur nga komunat si një nga sfidat kryesore në këtë drejtim, ku 50 % prej tyre kanë deklaruar se kanë nevojë për mbështetje profesionale gjatë këtij procesi.
- Në veçanti është përmendur HZK si një lloj i ri i dokumentit i cili përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit për tërë territorin e Komunës. Prej komunave të intervistuar, 42 % janë shprehur të kenë shumë paqartësi dhe konfuzitet si rreth përmbajtjes së HZK ashtu edhe rreth metodologjisë për hartimin e saj.
- Fleksibiliteti i ofruar përmes ndryshimeve dhe “bonuseve” në HZK konsiderohet si i rrezikshëm për shkak të mundësisë për ma-

nipulime dhe presionit politik në marrjen e vendimeve.

Ky proces gjithashtu kërkon një intenzitet të shtuar të konsultimit me publikun/palët e interesit, që është angazhim shtesë për zyrtarët e komunës. Në situatën kur komunat përballen me problemin e mos azhurnimit të hartave kadastrale dhe gjeodezike, kur nuk e kanë të ndërtuar sistemin informativ gjeografik (GIS) të domosdoshëm për krijimin e bazës së të dhënave të planifikimit hapësinor, dhe kanë mungesë të kuadrove të aftësuar, pajisjeve dhe mjeteve për zhvillimin e këtyre aktiviteteve, ato e shohin si shumë të vështirë hartimin dhe zbatimin e këtij dokumenti.

Problemet të cilat janë theksuar nga zyrtarët komunal gjatë hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor përfshijnë:

- Sigurimi i të dhënave të azhurnuara për fushat tematike të lartpërmendura, si një nga problemet kryesore që e përcjellin procesin e planifikimit. Të dhëna që kërkohen sipas UA për PZHK mungojnë dhe vështirë se mund të gjenerohen. Parakusht dhe bazë e çdo planifikimi të ardhshëm në komunë është analiza e gjendjes në hapësirë, në raport me resurset natyrore, demografinë, vendbanimet, shërbimet publike me infrastrukturë përcjellëse, infrastrukturën teknike, dhe mbrojtjen e mje-



Çështjet tematike, që për komunat janë më sfiduese gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor:

disit. Analiza e këtyre faktorëve, e bërë në bazë të të dhënave statistikore dhe nga terreni, mundëson vlerësimin e potencialeve dhe kufizimeve zhvillimore të komunës.

- Lidhur me banimin, që rangohet si një nga sfidat kryesore nga shumica e komunave është theksuar mungesa e ekspertizës së nevojshme për planifikimin e zhvillimit të këtij sektori.
- Përkundër faktit që shumë nga banesat e ndërtuara janë të pashfrytëzuara, ka presion të vazhdueshëm për ndërtime të reja.
- Parcelimi i paplanifikuar i ngastrave, i mosazhurnuar në kadastër dhe ndërtimet pa leje e pamundësojnë zbatimin e planeve. Kjo ndërlidhet edhe me humbjen e tokës bujqësore e cila është parcelizuar dhe shndërruar në tokë ndërtimore.
- Mungesa e tokës komunale për ofrimin e infrastrukturës së nevojshme për shërbime publike konsiderohet po ashtu një çështje e rëndësishme.

#### Konkluzionet dhe rekomandimet për tejkalimin e sfidave:

- Kompletimi sa më parë i kornizës ligjore është parakusht për zbatimin e dispozitave dhe obligimeve që rrjedhin nga LPH, në veçanti për komunat. Është shumë e nevojshme që stafi profesional i komunave të jetë i përfshirë në takimet punuese me fokus grupe për hartimin e akteve nënligjore të mbetura. Kjo do të mundësonte shtjellimin e përmbajtjes së ligjit dhe familjarizimin e tyre me sistemin e propozuar të planifikimit dhe menaxhimit hapësinor.
- MMPH duhet t'ju ofrojë mbështetje ligjore komunave në interpretimin e LPH dhe ligjeve tjera të ndërlidhura. Kontradiktat ligjore të LPH dhe ligjeve ndërlidhëse duhet të analizohen dhe jipen udhëzime të qarta për tejkalimin e tyre.
- LPH është ambicioz në raport me përmbushjen e kërkesave ligjore nga ana e komunave dhe kapaciteteve të tyre. Reformat ligjore nuk mund të ndryshojnë gjendjen aktuale në terren nëse nuk përcillen me aftësim adekuat të zyrtarëve të planifikimit dhe menaxhimit hapësinor. Përvoja e mëhershme ka dëshmuar se është e nevojshme ngritja në vazhdimësi e këtyre kapaciteteve. Komunat kanë nevojë për këshilla, asistencë teknike (mbështetje profesionale) dhe trajnime të specializuara në këtë fushë.
- LPH parasheh që komunat të hartojnë raporte vjetore të monitorimit të realizimit të qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara në dokumentet e planifikimit . Për të arritur këtë, hapi i parë i domosdoshëm është ndërtimi i një sistemi unik të informacionit, bazës të të dhënave hapësinore e cila duhet të menaxhohet dhe përditësohet rregullisht, dhe që përbën bazën për vlerësimin e përgjithshëm të ndryshimit të kontekstit më të gjerë social, ekonomik dhe mjedisor të komunës. Raportet duhet të hartohen sipas kriterëve teknike dhe metodologjike të përcaktuara me UA përkatës, dhe janë bazë për vlerësimin dhe rishikimin periodik të planeve sipas dispozitave ligjore. Analiza ka treguar që me kapacitetet aktuale njerëzore dhe teknike në komuna , kjo është vështirë e realizueshme. Kjo është një çështje shumë me rëndësi dhe gjetja e modaliteteve për ta adresuar duhet të jetë prioritet në të dy nivelet e qeverisjes.

- Duke pasur parasysh që në disa komuna këto plane janë hartuar/aprovuar para një dekade, ndërkohë që ka munguar një monitorim i mirëfilltë i zbatimit, procedimi me hartimin e HZK-ve bazuar në elementet strategjike të këtyre planeve, mund të reflektojë në planifikim dhe zhvillim joadekuat karshi situatës aktuale socio-ekonomike dhe hapësinore në komunë.
- Pavarësisht trajnimeve, ende nuk ka njohuri të mjaftueshme në përdorimin e GIS dhe krijimit të bazës së të dhënave. DU nuk janë përkrahur me sigurimin e softwerëve të licencuar për përdorim të GIS, dhe kompjuterë më të avancuar për të shfrytëzuar programin e GIS.
- LPH parasheh nxjerrjen e aktit nënligjor mbi rregullimin e mbikëqyrjes, ndëshkimeve dhe marrjen e masave ndaj çdo forme të shkeljes së këtij ligji. Ky akt duhet të shihet me prioritet më të lartë për Ministrinë. Rekomandimi është që gjatë hartimit të këtij akti nënligjor, kujdes i shtuar t'i kushtohet ndarjes më të qartë të roleve dhe përgjegjësi në rregullimin e kësaj fushe dhe sanksioneve për mos zbatimin e planeve të bëra nga subjektet e planifikimit hapësinor. Përfshirja e përfaqësuesve komunalë gjatë hartimit të këtij akti është e domosdoshme.


## 2.2. Kapacitetet njerëzore, organizative dhe financiare

### Kapacitetet njerëzore

Në nivelin lokal, LPH ka përcaktuar Autoritetin Përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor bartës të përgjegjësi për: hartimin dhe revidimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor (PZHk, HZK, PRrH), zhvillimin e procesit të pjesëmarrjes dhe shqyrtimit publik, monitorimin e zbatimit të objektivave të parashtruara dhe rishikimin e tyre, raportimin vjetor në MMPH lidhur me statusin aktual të dokumenteve të planifikimit hapësinor.

Përbushja e këtyre detyrave nga Drejtoritë komunale për planifikim dhe urbanizëm, si bartëse të këtyre përgjegjësi, është e kushtëzuar nga kapacitetet njerëzore dhe profesionale që ato i kanë në dispozicion. Ky dimension që konsiderohet të jetë me rëndësi kyçe për funksionim efikas të një institucioni/sektori, ka qenë një sfidë e vazhdueshme për administratat publike në shumë komuna.

Këtë e dëshmon edhe analiza e dalur nga intervistat me zyrtarët e komunave që nxjerr në pah të dhënat:



A keni numër të mjaftueshëm të stafit ne drejtori?

- 50% nga zyrtarët e intervistuar janë shprehur se drejtoritë e planifikimit dhe urbanizmit kanë kuadro profesionale (arkitektë dhe inxhinierë të ndërtimtarisë), një numër i të cilëve ka pasur një lloj trajnimi në fushën e planifikimit hapësinor. Mirëpo, vetëm tri komuna konsiderojnë se me kuadrot që kanë janë në gjendje të udhëheqin proceset e planifikimit dhe menaxhimit hapësinor, në pajtim me dispozitat e LPH.
- 70% e komunave kanë deklaruar se drejtoritë e planifikimit dhe urbanizmit nuk kanë numër të mjaftueshëm të zyrtarëve për të përbushur kërkesat që dalin nga LPH, kra-




has obligimeve që kanë në raport edhe me ligjet tjera të ndërlidhura ( Ligji i ndërtimit, Ligji për legalizimin e ndërtimeve pa leje,..).

- Komunat e vogla kanë më tepër sfida në raport me kapacitetet njerëzore. Ka raste kur aktivitetet e planifikimi t hapësinor mbuloohen vetëm nga një zyrtar, i cili vepron në kuadër të një drejtorie ku ofrohen edhe shërbime tjera të ndërlidhura (pronësore-juridike, gjeodezike, shërbime publike,..). Kështu punët lidhur me planifikim hapësinor, reduktohen në përcaktimin e kushteve të ndërtimit dhe dhënien e lejeve për ndërtim.
- Analiza ka treguar që në shumë raste, zyrtarët janë të angazhuar në përmbushjen e detyrave të drejtorive tjera (infrastrukturës, shërbimeve publike,..) që e pengon përkushtimin e tyre të plotë në çështjet e planifikimit.
- Mungesën e kapaciteteve njerëzore dhe ekspertizës për hartim dhe monitorim të dokumenteve të planifikimit hapësinor, në gjysmën e komunave të intervistuar e shohin si një problem serioz dhe vështirë të tejkalueshëm për shkak të kufizimeve ligjore nga ana e MAPL në raport me punësimin e zyrtarëve shtesë në administratën komunale.

### Kapacitetet organizative

Edhe pse definimi i sektorit të planifikimit si shërbim i veçantë në kuadër të strukturës së drejtorive të planifikimit dhe urbanizmit është bërë në 50% të komunave të intervistuar, në praktikë ato nuk funksionojnë si të tilla. Arsye për këtë lidhen me problemet e përmendura më lart: mungesa e stafit dhe kapaciteteve profesionale dhe mos përcaktimi i qartë i detyrave dhe përgjegjësisve në raport me sektorët tjerë në drejtori. Vetëm 2 nga komunat (Gjilani e Peja) janë shprehur të kenë sektorin e planifikimit hapësinor plotësisht në funksion të përgjegjësisve që ka.

Shumica e komunave pajtohen që sektori i Planifikimit hapësinor (niveli strategjik) duhet të funksionojë i ndarë nga ai i urbanizmit. Në këtë mënyrë do të ju mundësohej zyrtarëve të puno-



jnë në menaxhimin e proceseve të hartimit të dokumenteve të planifikimit, zbatimin e tyre dhe vlerësimin e rezultateve të arritura në pajtim me procedurat e përcaktuara me LPH.

### Kapacitetet financiare

Lidhur me planifikimin e buxhetit për zhvillimin e proceseve dhe hartimin e dokumenteve të planifikimit, 6 nga 14 komuna të intervistuar kanë deklaruar që kanë planifikuar buxhet për këtë qëllim.

Në gjashtë komunat që kanë planifikuar buxhet për hartim të dokumenteve të planifikimit sipas kërkesave ligjore, buxheti sillel nga 50,000€ në 100,000€. Buxheti i planifikuar, kryesisht do të shpenzohet për procesin e hartimit të Hartave Zonale Komunale.

Ndërsa në ato komuna të cilat nuk kanë planifikuar buxhet, zyrtarët e drejtorateve të urbanizimit sfidë kryesore e shohin mos interesimin e vendimmarrësve komunal për procese të planifikimit.

Shumica e zyrtarëve të intervistuar si nga komunat e mëdha ashtu edhe nga të tjerat, mendojnë që për Drejtoritë e planifikimit dhe urbanizmit nuk ndahet buxhet i nevojshëm për zhvillimin e veprimtarisë së tyre. Hartimi i planeve nuk shihet si prioritet në raport me projektet infrastrukturore ose të ndërtimit, ndërkohë që shpenzimet e shpronësimit të tokës për zbatim të planeve janë

shpesh herë të papërbalueshme. Për komunat e vogla të cilat nuk janë në gjendje të gjenerojnë shumë të hyra vetanake, ky problem është edhe më i shprehur.

Në pyetjen se si do te duhet të trajtohet sfida rreth ndarjes së pamjaftueshme të buxhetit për hartimin e dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të zhvillimit hapësinor, nga 14 komuna të intervistuar, 7 kanë deklaruar që kjo do të duhej të adresohet nëpërmes mbështetjes më të

fuqishme nga vendimmarrësit dhe vetëdijesimit të tyre për rëndësinë e procesit të planifikimit hapësinor. Për 3 nga komunat, shihet si mundësi edhe mbështetja nga MMPH – përmes bashkë-financimit ose asistencës teknike. Njëra nga komunat ka rekomanduar që kjo sfidë të tejkalohet nëpërmes rritjes së taksës komunale për objektet shumë banesore, ndërsa 3 nga komunat përmes sigurimit të donacioneve.

### Konkluzionet dhe rekomandimet për tejkalimin e sfidave

- Kapacitetet njerëzore, përmirësimi i organizimit institucional dhe politikave të buxhetimit janë faktorët kyç për funksionimin efikas të Autoriteteve komunale përgjegjëse për planifikim dhe menaxhim hapësinor. Këto çështje janë të një rëndësie të veçantë meqenëse zgjidhja e tyre shpesh është më e vështirë se sa çështjet teknike (sigurimi i pajisjeve dhe programeve të teknologjisë informative) që po ashtu janë të domosdoshme.
- Autoritetet komunale përgjegjëse për planifikim dhe menaxhim hapësinor nuk janë të përgatitura sa duhet për t'u përgjigjur në mënyrë adekuate kërkesave që janë vënë përpara me LPH. Ligji i ri sado i mirë mund të jetë, nuk mund ta përmirësojë gjendjen e vështirë në planifikim hapësinor, nëse nuk ka kapacitete njerëzore dhe mekanizma të duhur institucional për zbatimin e tij. Duhet të ndërmerren hapa të menjëhershëm drejt aftësisimit profesional të zyrtarëve të planifikimit, përmes trajnimeve adekuate për familjarizim sa më të mirë me LPH dhe llojet e e reja të planeve, zhvillimin dhe përdorimin e GIS-it, organizimit të përfshirjes së publikut. Kjo mund të bëhet përmes trajnimeve dhe asistencës teknike që mund të ofrohet nga niveli qendror si dhe formave të transferit të dijenisë përmes shkëmbimit të eksperiencës.
- Për rritjen e efikasitetit dhe kualitetit të punës së Autoriteteve komunale përgjegjëse për planifikim dhe menaxhim hapësinor, është e domosdoshme të bëhet një sistematizim dhe organizim adekuat i tyre, në kuptim të ndarjes së punëve të planifikimit – siç janë përcaktuar me LPH, nga ato të kontrollit të zhvillimit. Themelimi i ekipit komunal të planifikimit është i rëndësishëm së veçantë.
- Planifikimi hapësinor duhet të pranohet si një disiplinë që siguron zhvillim të qëndrueshëm dhe kërkon raporte efektive punuese mes politikanëve dhe sferave profesionale. Shtresa politike duhet të ketë rolin udhëheqës në procesin e bërjes së politikave zhvillimore dhe përkrahjes së planerëve gjatë hartimit dhe implementimit të planeve.
- Një pjesë e komunave kanë nevojë për përkrahje financiare në përgatitjen e planeve. Duke pasur parasysh nenin 26 paragrafi 4 sipas të cilit: nëse komunat dështojnë në përmbushjen e përgjegjësisë të tyre të parapara me dispozitat e këtij ligji, Ministria është përgjegjëse për hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor në nivel lokal në bashkëpunim me komunat, është e rekomandueshme që MMPH të shikojë mundësitë e ofrimit të kësaj mbështetjeje edhe përmes donatorëve të mundshëm.



- Përfundimisht, nga përgjigjet e komunave mund të konkludojmë që planifikimi i buxhetit për hartim të dokumenteve të planifikimit hapësinor varet nga vullneti politik i vendimmarrësve komunal. Në këtë kontekst, vendimmarrësit kanë nevojë të informohen më mirë se si planifikimi hapësinor është mjet i domosdoshëm për ngritjen e mirëqenies qytetare. Për të arritur këtë mirëqenie, planifikimi i drejtë i buxhetit komunal është hapi i parë.

## 2.3 Mbështetja politike bashkëpunimi ndër-institucional dhe më gjerë

### Mbështetja politike

Planifikimi hapësinor dhe proceset e tij kërkojnë qeverisje të mirë dhe mbështetje të fuqishme politike. Nga 14 komunat e intervistuar, rreth 53% janë deklaruar që kanë mbështetje të mjaftueshme politike, përdërisa 40% prej tyre kanë theksuar që planifikimi hapësinor ka pak mbështetje politike dhe 7% deklarojnë që mbështetja politike në planifikim hapësinor mungon tërësisht.

Duke marrë parasysh që planifikimi hapësinor është proces i vazhdueshëm, mbështetja politike jo gjithmonë është në nivelin e duhur, për arsyen se udhëheqësit komunal janë më shpesh në favor të intervenimeve apo projekteve të cilat japin efekt të menjëhershëm dhe rezultatet janë të dukshme brenda mandatit të tyre.



Sa keni mbështetje nga institucionet qendrore në trajtimin e sfidave të zhvillimit hapësinor dhe bashkërendimin e aktiviteteve?

Sa i përket mbështetjes nga institucionet qendrore në trajtimin e sfidave të zhvillimit hapësinor dhe bashkërendimin e aktiviteteve, 79% nga komunat e intervistuar janë deklaruar që kanë pak mbështetje nga niveli qendror përkatësisht MMPH-ja, 14% janë deklaruar se kanë shumë mbështetje, përdërisa 7% janë deklaruar që nuk kanë aspak mbështetje.

Është kërkuar që të standardizohet mënyra e komunikimit me nivelin qendror, duke iniciuar takime të rregullta mujore për të diskutuar për çështje të planifikimit hapësinor në mënyrë që komunat ta kenë më të lehtë përgjigjen në kërkesat apo sqarimet e kërkuara. Këto takime do të shërbenin që niveli qendror të jetë më afër sfidave reale të cilat paraqiten në nivelin lokal dhe kjo do të përmirësonte komunikimin vertikal në mes të institucioneve.

Mungesa e bashkëpunimit është vënë në pah edhe me institucionet tjera të nivelit qendror (ASK apo me ministritë tjera si ajo e Infrastrukturore apo Bujqësisë), me theks të veçantë gjatë planifikimit dhe ndërtimit të projekteve të mëdha infrastrukturore, shkëmbimin e të dhënave etj.

### Konkluzionet dhe rekomandimet për tejkalimin e sfidave

- Rëndësia e planifikimit hapësinor si një disiplinë shumë sektorale e cila koordinon dhe është e ndërvarur nga të gjitha strategjitë dhe programet kombëtare dhe lokale nuk është njohur si e tillë në nivel kombëtar. Kjo reflektohet edhe në nivelin lokal, ku ka munguar vullneti politik për të prioritetizuar forcimin e këtij sektori duke krijuar kapacitete vitale që do të jenë në gjendje të operojnë në mënyrë efikase në sistemin e ri të planifikimit hapësinor. Rekomandimi është që ti jipet theks i veçantë ngritjes së vetëdijes së politikanëve për të kuptuar rëndësinë e planifikimit hapësinor dhe për të siguruar zbatimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor.
- Niveli qendror ka obligim të krijojë kushte për planifikim hapësinor efektiv për nivelin lokal, si përmes hartimit të kornizës ligjore ashtu edhe përmes asistencës për të ndërtuar kapacitetin e nivelit lokal për të marrë përsipër detyrat e planifikimit hapësinor të përcaktuara me LPH. Kjo nënkupton një bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet MMPH dhe komunave si në aspekt të zbatimit të politikave ashtu edhe në ndërtim të kapaciteteve.
- MMPH duhet të ndihmojë komunat në lehtësimin e komunikimit me ministrinë dhe institucionet tjera në sigurimin e të dhënave dhe harmonizimin e planeve me politikat nacionale sektoriale.

## 2.4. Pjesëmarrja publike në proceset e planifikimit dhe menaxhimit hapësinor


Pjesëmarrja e publikut në hartim të dokumenteve të planifikimit siguron që plani të jetë i qëlluar. Në të njëjtën kohë duke marrë pjesë në hartim të dokumenteve të planifikimit, publiku mishërohet me planin, e fiton ndjenjën e pronësisë mbi planin si dhe angazhohet më shumë në zbatimin e tij.

Në pyetjen se si e vlerësojnë pjesëmarrjen e publikut, 77% e të intervistuarve kanë deklaruar se ajo është e pamjaftueshme, ndërsa vetëm 23% deklarojnë se ajo është e mirë.

Arsyet kryesore të pjesëmarrjes së pamjaftueshme dalin që janë:

- Mungesa e interesimit të publikut për të marrë pjesë në takimet e organizuara nga komuna
- Mosinformimi adekuat dhe mungesa e qasjes proaktive nga ana e komunës

Në lidhje me atë se cilat janë sfidat me të cilat ballafaqohen gjatë organizimit të aktiviteteve të




Si e vlerësoni pjesëmarrjen publike në proceset e planifikimit

pjesëmarrjes publike, komunat janë përgjigjur si në vijim:


- Gati gjysma e komunave kanë deklaruar se sfida më e madhe është sigurimi i pjesëmarrjes së kënaqshme
- 2 nga komunat kanë deklaruar se sfida është edhe informimi adekuat dhe efektiv i publikut, sepse qytetarët shpesh nuk lexojnë shpalljet komunale apo nuk ndjekin TV lokale, ku shpallen ftesat për debatet publike. Në

mënyrë indirekte, kjo tregon se disa komuna ndjekin rrugët e zakonshme të komunikimit dhe informimit, të cilat nuk dalin të jenë gjithmonë efektive.

- Kthimi i besimit të humbur të qytetarëve është sfidë për 2 nga komunat e intervistuar. Kjo është për shkak të mos zbatimit të planeve dhe mos përbushjeve të pritjeve të qytetarëve nga qeveria lokale.
  - Për 2 komuna sfidues është fakti se OJQ-të janë joaktive dhe pak të angazhuara në këtë drejtim, shpesh të politizuara e të paafta për të dhënë kontribut konstruktiv gjatë procesit të planifikimit
  - Mungesa e buxhetit për të organizuar takime është sfidë që vështirëson organizimin e aktiviteteve të pjesëmarrjes publike, përkundër interesimit dhe vullnetit të madh të komunës
  - Aty ku pjesëmarrja është e kënaqshme në kuptim të kuantitetit (numrit të pjesëmarrësve), mungon kualiteti. Pjesëmarrja nuk rezulton me komentim përmbajtësor në projekt-plane dhe kufizohet në komentet kryesisht teknike si gabime drejtshkrimore dhe çështje që prekin interesin personal. Rrallë herë ndodh të artikulohet interesi publik nga këto procese.
  - Në veçanti brengosëse është mosinteresimi i profesionistëve të fushës për të kontribuar gjatë aktiviteteve të konsultimeve publike.
- Veprimet e domosdoshme për rritjen e pjesëmarrjes publike sipas rangimit nga komunat janë:
- Të bëhet sensibilizimi dhe ngritja e vetëdijes së qytetarëve për rëndësinë e pjesëmarrjes në proceset e planifikimit dhe nxitja e tyre për pjesëmarrje përmbajtësore. Ceket edhe sensibilizimi për pjesëmarrje pa ndikime politike dhe kultivimi i kulturës së pjesëmarrjes (respektimi i njoftimeve dhe përgjigja në ftesat e dërguara nga komuna);
  - Të gjenden mënyra për motivimin dhe stimulimin e qytetarëve për të marrë pjesë, sipas nevojës edhe stimulim simbolik material;
  - Informimi, lobimi dhe organizimi i duhur dhe i kujdesshëm. Është cekur se duhet t'i kushtohet rëndësi kohës së mbajtjes së takimeve me publikun;
  - Propozohet që pjesëmarrja të futet në plan-program të edukimit dhe arsimit të brezave të ardhshëm në mënyrë që studentët dhe profesionistët të kuptojnë rëndësinë e kësaj dhe të jenë aktiv në procese të tilla;
  - Duhet të përmirësohet performanca e komunës në zbatim të planeve në mënyrë që të kthehet besimi i qytetarëve dhe motivimi i tyre për pjesëmarrje.



Sfidat me të cilat ballafaqohen komunat gjatë organizimit të aktiviteteve të pjesëmarrjes



Çfarë veprimesh duhet ndërmarrë në rritjen e pjesëmarrjes publike në proceset e zhvillimit hapësinor?

#### Rekomandimet dhe konkluzionet:

- Të gjitha komunat pajtohen se publiku duhet të jetë pjesë aktive e planifikimit hapësinor dhe se duhet të punohet në këtë drejtim;
- Publiku ka nevojë për ngritje të vetëdijes për rëndësinë e pjesëmarrjes në planifikim hapësinor, por edhe për ngritje të kapaciteteve, në mënyrë që të jetë në gjendje të jep kontribut substancial dhe të kuptojë përfitimet e tij nga përfshirja në plan;
- Komunat duhet të kenë qasje më kreative në kyçjen e publikut dhe t'i përdorin kanalet e informimit të cilat i përdor edhe publiku, në mënyrë që të arrijnë sa më afër tij;
- Kur vendoset të zhvillohet ndonjë proces i planifikimit hapësinor, paralel me buxhetin për harfim/zbatim, duhet të alokohet edhe buxheti për pjesëmarrjen publike në atë proces, në mënyrë që kjo të mos pamundësojë pjesëmarrjen e nevojshme dhe të kënaqshme;
- OJQ-të duhet të jenë më aktive në këtë drejtim, të jenë të paanshme, jo politike, dhe të japin kontribut konstruktiv (profesional).

### III. ROLI I SHOQËRISË CIVILE NË TRAJTIMIN E SFIDAVE

Analiza ka treguar që roli i shoqërisë civile në trajtimin e sfidave të planifikimit dhe menaxhimit hapësinor është shumëdimensional në varësi të profilizimit të tyre. Rekomandohet që shoqëria civile të jetë më aktive, sepse në këtë mënyrë do të ndikohet në rritjen e ndërgjegjësimit publik për rëndësinë e pjesëmarrjes publike në proceset e planifikimit. Përderisa OShC e orientuara në fusha të caktuara të cilat janë të rëndësishme për planifikimin hapësinor, mund të kontribuojnë me ekspertizën e tyre, OShC me bazë nga komuniteti mund të ofrojnë informata të rëndësishme lidhur me situatën në terren dhe çështjet prioritare për komunitetin. Sipas komunave të intervistuar OShC lokale edhe kur marrin pjesë në proces, nuk janë shumë aktive në kuptim të kontributit konstruktiv.

Komunat konsiderojnë që angazhimi i OShC-ve në planifikim hapësinor është i domosdoshëm, si gjatë hartimit të kornizës ligjore ashtu edhe gjatë procesit të hartimit dhe zbatimit të planeve.

Në kuadër të kornizës ligjore dhe hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor:

- Organizimin e debateve përmes formave të ndryshme: seminare, tryeza të rrumbullakëta ku do të diskutohet mbi aspektet ligjore, çështjet e ndryshme të planifikimit hapësinor dhe pjesëmarrjes publike në këto procese;
- Në bashkëpunim me komunën, OShC mund të kryejnë hulumtime të caktuara në terren apo analiza në funksion të planifikimit;
- Të ofrojnë këshilldhënje dhe mbështetje teknike gjatë procesit të hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor, trajnime specifike tematike, hartim të udhëzuesve (kjo vlen për OShC të specializuara);
- Ndërmarr fushata sensibilizimi për vetëdijësimin e politikanëve, sidomos deputëve të Kuvendit Komunal për rëndësinë e planifikimit hapësinor;
- Të llobojnë tek donatorët për mbështetjen e projekteve që kanë të bëjnë me avancimin e fushës së planifikimit dhe sektorëve ndërlidhës;
- Të organizojë platforma të ndryshme ku mund të ngriten çështjet dhe diskutohen sfidat e përgjithshme të planifikimit dhe menaxhimit hapësinor;
- Të ndihmojë bashkëpunimin ndër-institucional dhe më gjerë;
- Të avokojë për çështjet e planifikimit hapësinor tek institucionet gjegjëse;
- Të monitorojë dhe raportojë në vazhdimësi mbi përmbushjen e detyrimeve ligjore të planifikimit dhe menaxhimit hapësinor nga ana e autoriteteve përgjegjëse (lokale dhe qendrore)

#### Në kuadër të pjesëmarrjes së publikut

Gjatë procesit të hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor, UA Nr.05 / 2014, për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat e pjesëmarrjes së publikut në planifikim hapësinor, parasheh organizimin e diskutimeve publike dhe forma tjera të pjesëmarrjes publike për definimin e vizionit, objektivave, prioritetëve strategjike dhe çështjeve të tjera. Kërkesa minimale për pjesëmarrjen e publikut është që të sigurojë të paktën një diskutim publik për çdo fazë të procesit të planifikimit. I udhëhequr si duhet një proces i tillë krijon hapësirë të mjaftueshme për pjesëmarrje përmbajtësore të publikut. Ajo që në shumicën e komunave është sfiduese lidhet me problemin e vullnetit për bërjen më transparent të procesit të planifikimit, kapaciteteve të pamjaftueshme njerëzore por edhe mungesës së shkathtësive të zyrtarëve komunal për të zhvilluar teknika adekuate të pjesëmarrjes publike. Kjo sfidë do të mund të adresohet përmes bashkëpunimit me

OShC si në:

- Mobilizimin e të gjitha palëve të interesit dhe përfshirjen e tyre në diskutimet publike;
- Ngritjen e vetëdijes dhe sensibilizimin e publikut për pjesëmarrje aktive në proceset e planifikimit hapësinor dhe atë në kuptim të artikulimit të interesit publik dhe jo vetëm të kërkesave individuale;
- Ofrimin e mbështetjes në organizimin e konsultimeve publike dhe formave tjera të pjesëmarrjes gjatë të gjitha fazave të hartimit të dokumenteve të planifikimit për të siguruar një proces transparent dhe gjithëpërfshirës dhe raporti komunë-qytetar më i relaksuar (kur është një palë e tretë që e menaxhon procesin);
- Publikimin e materialeve informuese dhe shpërndarjen e informacionit tek publiku për aktivitetet e PH;
- Fasilitimin e dialogut: Qytetar-Komunë dhe ndërtimin e besimit të ndërsjellë;
- Ofrimin e trajnimeve për grupet e caktuara të interesit në veçanti atyre të marginalizuara për pjesëmarrjen në proceset e planifikimit hapësinor.

## REFERENCAT

1. MMPH, Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174, 2013;
2. MMPH, Ligji për planifikim hapësinor, UA Nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor;
3. MMPH, Ligji për planifikim hapësinor, UA Nr.11/2015 për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal;
4. MMPH, Ligji për planifikim hapësinor, UA Nr.24/2015 për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës
5. Intervistat me drejtorë dhe zyrtarë komunalë në komunat: Prishtina, Peja, Prizreni, Gjilani, Ferizaj, Vushtrria, Fushë Kosova, Klina, Podujeva, Kamenica, Malisheva, Graçanica, Juniku dhe Mamusha.







Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Swiss Cooperation Office Kosovo**

Ky projekt/program është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)